

VENDIM
Nr. 170, datë 24.3.2023

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT PËR PROGRAMIN
KOMBËTAR TË MODERNIZIMIT TË SEKTORIT TË UJËSJELLËS-
KANALIZIMEVE NË SHQIPËRI, NGA FONDI I MIRËBESIMIT ME NJË
DONATOR, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, QË VEPRON SI
ADMINISTRATORE E PROGRAMIT KOMBËTAR TË MODERNIZIMIT TË
SEKTORIT TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE NË SHQIPËRI, NGA FONDI I
MIRËBESIMIT ME NJË DONATOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit për Programin Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Ujësjellës-Kanalizimeve në Shqipëri, nga Fondi i Mirëbesimit me një Donator, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administratore e Programit Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Ujësjellës-Kanalizimeve në Shqipëri, nga Fondi i Mirëbesimit me Një Donator, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyjnë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

NUMRI I GRANTIT TF0B8448-AL

PROGRAMI KOMBËTAR I MODERNIZIMIT
TË SEKTORIT TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE NË SHQIPËRI NGA FONDI I
MIRËBESIMIT ME NJË DONATOR

MARRËVESHJE GRANTI
(PROJEKTI I PROGRAMIT KOMBËTAR TË MODERNIZIMIT TË SEKTORIT TË
UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE NË SHQIPËRI)
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
(QË VEPRON SI ADMINISTRATORE E PROGRAMIT KOMBËTAR TË
MODERNIZIMIT TË SEKTORIT TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE NË SHQIPËRI
NGA FONDI I MIRËBESIMIT ME NJË DONATOR)

NUMRI I GRANTIT TF0B8448-AL

MARRËVESHJE GRANTI

Marrëveshja e hyrë në fuqi në datën e nënshkrimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë (“Përfituesi”) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka”), që vepron si administratore e Programit Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Ujësjellës-Kanalizimeve në Shqipëri nga Fondi i Mirëbesimit me Një Donator,

duke pasur parasysh se Banka ra dakord t'i japë një hua Republikës së Shqipërisë në shumën prej gjashtëdhjetë e shtatë milionë e treqind mijë euro (67,300,000 €) për ta ndihmuar në financimin e Programit të përshkruar në skedulin 1 të Marrëveshjes së Huas (siç përcaktohet në këtë dokument), sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në Marrëveshjen e Huas, tashmë, si rrjedhojë, Përfituesi dhe Banka bien dakord, si më poshtë:

Neni 1

Kushtet standarde; përkufizimet

1.01. Kushtet standarde (siç përcaktohen në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje) zbatohen dhe janë pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

1.02. Me përjashtim të rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe, termat me shkronjë të madhe në këtë Marrëveshje kanë kuptimet përkatëse të parashikuara në Kushtet Standarde ose në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

Neni II

Projekti

2.01. Përfituesi deklaron angazhimin e tij ndaj objektivave të projektit të përshkruar në skedulin 1 të kësaj Marrëveshjeje ("Projekti"). Për këtë qëllim, Përfituesi, nëpërmjet MIE-s, do të marrë masa që Projekti të kryhet nga Enti Zbatues i Projektit, në përputhje me dispozitat e nenit II të Kushteve Standarde dhe skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni III

Granti

3.01. Banka pranon t'i japë Përfituesit, sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara ose të referuara në këtë Marrëveshje, një grant me shumë fillestare, që nuk i kalon tre milionë dollarë amerikanë (3,000,000 dollarë) ("Shuma fillestare") plus çdo shumë pasuese ose shumat që do të specifikohen me njoftim për Përfituesin dhe të cilat nuk duhet të kalojnë në total gjashtë milionë e treqind mijë dollarë amerikanë (6,300,000 dollarë), nëse dhe këto shuma pasuese vihen në dispozicion nga donatori, në kuadër të Programit Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Ujësjiellës-Kanalizimeve në Shqipëri nga Fondi i Mirëbesimit me Një Donator për të ndihmuar në financimin e Projektit.

Totali i shumës fillestare plus shumat pasuese të përmendura, nëse ka, do të përbëjnë në vijim grantin ("Granti"). Përfituesi konfirmon mirëkuptimin dhe bie dakord që shuma e Grantit të dhënë sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë e kufizuar: i. në çdo kohë për fondet e disponueshme për Bankën nga Programi Kombëtar i Modernizimit të Sektorit të Ujësjiellës-Kanalizimeve në Shqipëri nga Fondi i Mirëbesimit me Një Donator; dhe ii. në shumën fillestare, përveç nëse dhe derisa Banka, në një datë të mëvonshme, t'i ketë dërguar njoftim Përfituesit, duke specifikuar ndonjë shumë ose shuma pasuese që do t'i shtohen shumës fillestare.

3.02. Përfituesi mund të tërheqë të ardhurat e Grantit në përputhje me Seksionin III të skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

3.03. Granti financohet nga fondi i mirëbesimit i lartpërmendur për të cilin Banka merr kontribute periodike nga donatori në fondin e mirëbesimit. Në përputhje me seksionin 3.02 të Kushteve Standarde, detyrimet e pagesës së Bankës në lidhje me këtë Marrëveshje janë të kufizuara në shumën e fondeve të vëna në dispozicion të saj nga donatori në fondin e lartpërmendur të mirëbesimit, dhe e drejta e Përfituesit për të tërhequr të ardhurat e Grantit është objekt i disponueshmërisë së këtyre fondeve.

Neni IV

Mjetet juridike shitesë

4.01. Rasti Shtesë i Pezullimit i përmendur në Seksionin 4.02(k) të Kushteve Standarde përbëhet si në vijim:

a) se legjislacioni i AKUM-it është ndryshuar, pezulluar, shfuqizuar, anuluar ose hequr dorë, në mënyrë që të ndikojë materialisht dhe negativisht, sipas mendimit të Bankës, në aftësinë e Përfituesit për të kryer ndonjë nga detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje;

b) se çdo ndërmarrje e Ujësjellës-Kanalizimeve (UK) ose Njësi e Qeverisjes Vendore nuk ka përmbushur asnjë nga detyrimet e saj sipas Marrëveshjes së saj përkatëse të Performancës.

Neni V

Hyrja në fuqi; zgjidhja

5.01. Kjo Marrëveshje nuk do të hyjë në fuqi derisa Bankës t'i sigurohen prova të mjaftueshme se janë përmbushur kushtet e specifikuar në vijim:

a) Ekzekutimi dhe realizimi i kësaj Marrëveshjeje në emër të Përfituesit janë autorizuar siç duhet nga të gjitha veprimet e nevojshme qeveritare.

b) Manuali Operacional i Projektit është miratuar nga Përfituesi, nëpërmjet MIE-s dhe AKUM-it në mënyrën dhe përmbushjen e pranueshme për Bankën; dhe

c) Marrëveshja e Huas është ekzekutuar dhe realizuar dhe janë përmbushur të gjitha kushtet paraprake për hyrjen në fuqi të marrëveshjes në fjalë.

5.02. Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, Përfituesi do të konsiderohet se përfaqëson dhe garanton që në Datën e Nënshkrimit, Marrëveshja e Grantit është autorizuar, ekzekutuar dhe dorëzuar në emër të Përfituesit dhe është ligjërish e detyrueshme për Përfituesin, në përputhje me kushtet e saj, përveç rasteve kur kërkohet veprim shtesë për ta bërë këtë Marrëveshje ligjërish të detyrueshme. Kur kërkohet veprim shtesë pas Datës së Nënshkrimit, Përfituesi do të njoftojë Bankën kur është ndërmarrë ky veprim shtesë. Pas njoftimit, Marrësi do të konsiderohet se përfaqëson dhe garanton që në datën e këtij njoftimi Marrëveshja e Grantit është ligjërish e detyrueshme për Përfituesin në përputhje me kushtet e saj.

5.03 Përveç rasteve kur Përfituesi dhe Banka do të bien dakord ndryshe, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën kur Banka i dërgon Përfituesit njoftimin për pranimin e provave të kërkuara sipas seksionit 5.01 ("Data e hyrjes në fuqi"). Nëse, para datës së hyrjes në fuqi, ka ndodhur ndonjë rast që do t'i jepte të drejtë Bankës të pezullonte të drejtën e Përfituesit për të kryer tërheqje nga llogaria e grantit, nëse kjo Marrëveshje do të kishte qenë efektive, Banka mund të shtyjë dërgimin e njoftimit të përmendur në këtë seksion derisa ky rast (ose rastet) të ketë (ose të kenë pushuar) së ekzistuari.

5.04. Kjo Marrëveshje dhe të gjitha detyrimet e palëve sipas saj do të përfundojnë, nëse marrëveshja nuk ka hyrë në fuqi deri në 90 (nëntëdhjetë) ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje. Përveç rastit kur Banka, pas shqyrtimit të arsyeve të vonësës, cakton një datë të mëvonshme për qëllimin e këtij seksioni, Banka do të njoftojë menjëherë Përfituesin për këtë datë të mëvonshme.

Neni VI

Përfaqësuesi i Përfituesit; Adresat

6.01. Përfaqësuesi i Përfituesit i përmendur në seksionin 7.02 të Kushteve Standarde është ministri përgjegjës për financat.

6.02. Për qëllimet e seksionit 7.01 të Kushteve Standarde:

a) adresa e Përfituesit është:

Ministria e Financave

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", 3

Tiranë, Shqipëri; dhe

b) Adresa elektronike e Përfuturës është:

E-mail: sekretariamin@financa.gov.al

6.03 Për qëllimet e seksionit 7.01 të Kushteve Standarde:

a) adresa e Bankës është:

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim

1818 H Street, N.W.

Washington, D C. 20433

Shtetet e Bashkuara të Amerikës; dhe

b) Adresa elektronike e Bankës është:

Teleks: 248423 (MCI) ose 64145 (MCI)

Faks: 1-202-477-6391

E-mail: esalinas@worldbank.org

Palët RANË DAKORD në Datën e Nënshkrimit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga / nënshkrimi/

Përfaqësues i Autorizuar

Emri: DELINA IBRAHIMAJ

Titulli: MINISTËR I FINANCËVE DHE EKONOMISË

Data: 15.12.2022

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (që vepron si
administratore e Programit Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Ujësjetës-Kanalizimeve në Shqipëri nga
Fondi i Mirëbesimit me Një Donator)

Nga...../ nënshkrimi/

Përfaqësuesi i Autorizuar

Emri: EMANUEL SALINAS

Titulli: MENAXHER I VENDIT

Datë: 8 DHJETOR 2022

SKEDULI 1 PËRSHKRIMI I PROJEKTT

Objektivat e Projektit, si pjesë e Operacionit, janë përmirësimi i performancës operacionale dhe financiare të ndërmarrjeve të ujësjetës-kanalizimeve (UK) dhe rritja e aksesit në shërbimet e ujësjetës të menaxhuar në mënyrë të sigurt në Republikën e Shqipërisë.

Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

I. Forcimi i Kuadrit Kombëtar të Sektorit të Ujësjetës-Kanalizimeve.

1. Sigurimi i asistencës teknike dhe veprimtarive të zhvillimit të kapaciteteve për të forcuar kuadrin kombëtar të sektorit të ujësjetës-kanalizimeve, duke përfshirë hartimin e:

a) kërkesave për qeverisjen e korporatës, përgjegjshmërinë financiare dhe transparencën për ndërmarrjet e UK-së;

b) sistemit vjetor për vlerësimin e performancës për ndërmarrjet e Ujësjetës-Kanalizimeve;

c) udhëzuesit për biznesin dhe planet e përmirësimit të performancës së ndërmarrjeve të UK-së;

d) procedurave standarde të operacionit për kualifikimin dhe rishikimin e nënprojekteve të investimeve sipas Pjesëve 2 dhe 3 të Programit; dhe

e) monitorimit dhe vlerësimit të ndërmarrjeve të UK-së;

2. Aktivitete mësimore dhe trajnimi për stafin nga institucionet e sektorit të nivelit qendror dhe zhvillimi i programit kombëtar të trajnimit dhe certifikimit të bazuar në teste për stafin e ndërmarrjeve të UK-së;

3. Aktivitete të komunikimit dhe informimit mbi nismat dhe politikat e strategjisë kombëtare, duke përfshirë politikat dhe iniciativat për të promovuar përfshirjen gjinore, sociale dhe angazhimin e qytetarëve; dhe

4. Veprimtaritë mbështetëse për shkëmbimin e njohurive për një koordinim të përmirësuar të sektorit të ujit.

II. Performanca e përmirësuar financiare dhe operationale e ndërmarrjeve të Ujësjetës-Kanalizimeve

1. Ofrimi i asistencës teknike për të përmirësuar performancën financiare dhe operationale të ndërmarrjeve të UK-së, duke përfshirë:

a) kryerjen e auditimeve të eficiencës energjetike dhe studimit të vlerësimit të burimeve të sistemit FV diellor;

b) përgatitjen e planeve të biznesit, planeve të përmirësimit të performancës, planeve të menaxhimit të rrezikut ose sigurisë së ujit dhe propozimeve për tarifën për ndërmarrjet e UK-së, duke përfshirë studimet e fizibilitetit të nënprojekteve të investimeve të identifikuar në këto plane;

c) kryerjen e anketave të komenteve dhe përvojës së qytetarëve për ofrimin e shërbimeve, shërbimet e marra ndaj klientit dhe veprimtarive të tjera të angazhimit të qytetarëve;

d) studimet e fizibilitetit për të siguruar procesin e kujdesit të duhur dhe aspektet e ndërlidhura të rajonalizimit të ndërmarrjeve të UK-së, duke përfshirë ndër të tjera, në lidhje me qeverisjen ligjore, institucionale, teknike, tregtare, financiare, mjedisore dhe sociale; dhe

e) përgatitjen dhe zbatimin e pilotëve të rajonalizimit të ndërmarrjeve të UK-së.

2. Aktivitete mësimore dhe trajnuese për zhvillimin profesional të ndërmarrjeve të UK-së dhe njësive qendrore vendore në fushat prioritare, duke përfshirë, ndër të tjera, zbatimin e procedurave standarde të operacionit në përgatitjen dhe zbatimin e nënprojekteve të investimeve, prokurimin dhe menaxhimin financiar, si dhe menaxhimin e aspekteve mjedisore dhe sociale.

III. Mbyllja e mangësive të Shërbimeve të Përgjithshme të Ujësjetës

1. Ofrimi i asistencës teknike për përgatitjen, *ndër të tjera të:* i. punës kërkimore dhe analitike të nevojshme për të mbështetur përpunimin e procedurave të operacionit për financimin e nënprojekteve të reja të lidhjes së sistemit të ujësjetës-kanalizimeve sipas pjesës 3 të Programit; ii. udhëzuesit për investimet në sistemin e kanalizimeve në terren; dhe iii. studimeve të fizibilitetit;

2. Aktivitete të komunikimit dhe informimit për skemën e mbështetjes sociale (mekanizmi i subvencionimit të lidhjes) për të rritur përfshirjen e familjeve të cënueshme; dhe

3. Zhvillimi i kapaciteteve, *ndër të tjera i:* i. zbatimit të procedurave për përgatitjen e nënprojekteve të aksesit të përgjithshëm nga ndërmarrjet e UK-së dhe Njësive Vendore Qendrore; dhe ii. informimit, edukimit, komunikimit dhe ndryshimit të sjelljes për familjet e cënueshme, duke përfshirë minoritetet romë.

IV. Forcimi i Kapaciteteve për Menaxhimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Programit

Mbështetja e zhvillimit të kapaciteteve dhe aktiviteteve të asistencës teknike në interes të subjekteve zbatuese pjesëmarrëse për zbatimin e Programit, duke përfshirë, por pa u kufizuar të fushat e koordinimit dhe menaxhimit të programit, menaxhimit mjedisor dhe social, si dhe menaxhimin financiar dhe prokurimit.

V. Verifikimi i treguesve që lidhen me disbursimin (DLI), Auditimet e Programit dhe Monitorimi, Vlerësimi dhe Raportimi i Ecurisë

Ofrimi i asistencës teknike për verifikimin vjetor të rezultateve dhe treguesve që lidhen me disbursimin, në përputhje me protokollin e verifikimit të rënë dakord në kuadër të Programit, përgatitja e auditimeve të programit dhe raportet e ecurisë.

SKEDULI 2 ZBATIMI I PROJEKTTIT

Seksioni I. Masa institucionale dhe masa të tjera

A. Masat institucionale

1. Jo më vonë se tre (3) muaj pas Datës së Hyrjes në Fuqi, Përfituesi, nëpërmjet MIE-s, do të krijojë dhe më pas do të mbajë gjatë gjithë zbatimit të projektit, Njësinë e Monitorimit të Projektit ("NJMP") me stafin kryesor, duke përfshirë të paktën menaxherin e Projektit, specialistin ligjor/për institucionin dhe specialistin për monitorimin dhe vlerësimin, të gjithë të pajisur me kualifikime, përvojë, përgjegjësi dhe terma referencë të pranueshëm për Bankën; të jenë përgjegjës për monitorimin e Projektit dhe përgjegjësitë e tjera të përcaktuara në Manualin Operacional të Projektit.

2. Jo më vonë se 3 (tre) muaj pas Datës së Hyrjes në Fuqi, Përfituesi, nëpërmjet MIE-s, do të marrë masa që AKUM-i të krijojë dhe më pas të mbajë gjatë gjithë zbatimit të projektit, Njësinë e Koordinimit të Projektit ("NJKP") me stafin kryesor, duke përfshirë të paktën një menaxher/koordinator të Projektit, specialist ligjor, specialist teknik të ujit, specialist analist të biznesit për ujin, specialist të menaxhimit dhe monitorimit të të dhënave, specialist të menaxhimit financiar, specialist prokurimi, specialist të punëve sociale, specialist të angazhimit të qytetarëve dhe komunikimin dhe specialist mjedisor, të gjithë të pajisur me kualifikime, përvojë, përgjegjësi dhe terma referencë të pranueshëm për Bankën; me përgjegjësitë e përcaktuara në Manualin Operacional të Projektit.

B. Manuali Operacional i Projektit

1. Përfituesi, nëpërmjet MIE-s, do të miratojë dhe do të marrë masa që Enti Zbatues i Projektit të miratojë Manualin Operacional të Projektit, si pjesë e Manualit Operacional të Programit, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, që përmban rregullime dhe procedura të detajuara, për: a) koordinimin institucional dhe ekzekutimin e përditshëm të Projektit; b) buxhetimin e projektit, disbursimin dhe menaxhimin financiar; c) prokurimin; d) udhëzuesin për mbrojtjen mjedisore dhe sociale; e) monitorimin, vlerësimin, raportimin dhe komunikimin; dhe f) marrëveshjet dhe procedurat e tjera administrative, financiare, teknike dhe organizative që do të kërkohen për Projektin.

2. Përfituesi, nëpërmjet MIE-s, do të kryejë dhe do të marrë masa që Projekti të realizohet, në përputhje me udhëzuesin dhe procedurat e përcaktuara në Manualin Operacional të Projektit (me kusht që, megjithatë, në rast të ndonjë konflikti ndërmjet marrëveshjeve dhe procedurave të përcaktuara në Manualin Operacional të Projektit dhe në dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të kenë përparësi, përveç rasteve kur Banka bie dakord ndryshe, nuk do të ndryshojë, shfuqizojë ose heqë dorë nga asnjë dispozitë e Manualit Operacional të Projektit.

C. Plani vjetor i punës dhe buxheti

1. Jo më vonë se në datën 30 nëntor në çdo vit kalendarik (ose një muaj pas Datës së Hyrjes në Fuqi për vitin e parë të zbatimit të projektit), Përfituesi, nëpërmjet MIE-s, duhet të përgatisë ose të marrë masa që të përgatitet për qëllimin e dërgimit në Bankë; i. një draft i planit vjetor të punës dhe buxhetit për Projektin (duke përfshirë kostot e trajnimit dhe ato operative) për vitin vijues kalendarik të zbatimit të Projektit, me objektin dhe detaje që Banka ka kërkuar në mënyrë të arsyeshme; dhe ii. çdo instrument të kërkuar nga ESCP-ja për zbatimin e veprimtarive të përfshira në draftin e planit vjetor të punës dhe në buxhet.

2. Përfituesi, nëpërmjet MIE-s, do t'i japë Bankës një mundësi të arsyeshme për të rishikuar këtë draft të planit vjetor të punës dhe buxhetit dhe, më pas, të zbatojë (ose të marrë masa që të

kryhet) planin vjetor të punës dhe buxhetin gjatë atij viti kalendarik pasues që do të jetë miratuar nga Banka ("Plani Vjetor i Punës dhe Buxheti"). Vetëm ato veprimtari që janë të përfshira në Planin Vjetor të Punës dhe Buxhet do të pranohen për financim nga të ardhurat e Financimit.

3. Veprimtaritë e trajnimit të propozuara për t'u përfshirë në Planin Vjetor të Punës dhe Buxhet, do të përfshijnë, *ndër të tjera*: a) të dhënat e trajnimit të parashikuar; b) kriteret për përzgjedhjen e personelit që do të trajnohet dhe këtë personel, nëse dihet; c) metodën e përzgjedhjes së institucionit ose individëve që kryejnë këtë trajnim; institucionin që kryen këtë trajnim, nëse identifikohet; e) qëllimin dhe arsyetimin për këtë trajnim; f) vendndodhjen dhe kohëzgjatjen e trajnimit të propozuar; dhe g) vlerësimin e kostos së këtij trajnimi dhe çdo udhëtimi që lidhet me këtë trajnim.

4. Plani Vjetor i Punës dhe Buxheti mund të rishikohen sipas nevojës gjatë zbatimit të Projektit, në bazë të miratimit paraprak me shkrim të Bankës.

D. Standardet Mjedisore dhe Sociale

1. Përfituesi, nëpërmjet MIE-s, duhet dhe do të marrë masa që Enti Zbatues i Projektit të garantojë që Projekti të kryhet në përputhje me standardet mjedisore dhe sociale, në një mënyrë të pranueshme për Bankën.

2. Pa u kufizuar në paragrafin 1 më sipër, Përfituesi, nëpërmjet MIE-s, duhet dhe do të marrë masa që Enti Zbatues i Projektit të garantojë që Projekti të zbatohet, në përputhje me Planin e Angazhimit Mjedisor dhe Social ("ESCP"), në një mënyrë të pranueshme për Bankën. Për këtë qëllim, Përfituesi, nëpërmjet MIE-s, duhet dhe do të marrë masa, që Enti Zbatues i Projektit të garantojë që:

a) masat dhe veprimet e specifikuar në ESCP zbatohen me kujdesin dhe efikasitetin e duhur dhe parashikohen në ESCP;

b) janë të disponueshme fonde të mjaftueshme për të mbuluar kostot e zbatimit të ESCP-së;

c) politikat dhe procedurat zbatohen dhe personeli i kualifikuar dhe me përvojë në numër të përshatshëm punësohet për zbatimin e ESCP-së, siç parashikohet në ESCP; dhe

d) ESCP ose ndonjë dispozitë e saj nuk ndryshohet, shfuqizohet, pezullohet ose hiqet dorë, përveç rasteve kur Banka bie dakord ndryshe me shkrim, siç specifikohet në ESCP, dhe garanton që ESCP e rishikuar publikohet menjëherë pas kësaj.

3. Në rast të ndonjë mospërputhjeje ndërmjet ESCP-së dhe dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të kenë përparësi.

4. Përfituesi, nëpërmjet MIE-s, duhet dhe do të marrë masa që Enti Zbatues i Projektit të garantojë që:

a) janë marrë të gjitha masat e nevojshme për mbledhjen, përpilimin dhe dorëzimin në Bankë përmes raporteve të rregullta, me shpeshtësinë e specifikuar në ESCP, dhe menjëherë në një raport ose raporte të veçanta, nëse kërkohet nga Banka, informacion mbi statusin e përputhshmërisë me ESCP-në dhe instrumentet mjedisore dhe sociale të referuara në këtë dokument, të gjitha këto raporte duhet të jenë në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, duke përcaktuar, ndër të tjera: i. statusin e zbatimit të ESCP-së; ii. kushtet, nëse ka, të cilat ndërhyjnë ose rrezikojnë të ndërhyjnë në zbatimin e ESCP-së; dhe iii. masat korrigjuese dhe parandaluese të marra ose që kërkohen të merren për të trajtuar këto kushte; dhe

b) Banka njoftohet menjëherë për çdo incident ose aksident që lidhet ose ka ndikim në Projekt, i cili mund ose ka të ngjarë të ketë një ndikim negativ të konsiderueshëm në mjedis, komunitetet e prekura, njerëzit ose punëtorët, në përputhje me ESCP-në, instrumentet mjedisore dhe sociale të referuara në këtë dokument dhe Standardet Mjedisore dhe Sociale.

5. Përfituesi, nëpërmjet MIE-s, duhet dhe do të marrë masa që Enti Zbatues i Projektit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e hyrjes në fuqi, të krijojë, publikojë, mirëmbajë dhe përdorë një mekanizëm të aksesueshëm për ankesat, për të marrë dhe lehtësuar zgjidhjen e problemeve dhe ankesave të personave të prekur nga Projekti dhe për të marrë të gjitha masat e nevojshme dhe të përshatshme për të zgjidhur ose për të lehtësuar zgjidhjen e këtyre problemeve dhe ankesave në një mënyrë të pranueshme për Bankën.

6. Përfituesi, nëpërmjet MIE-s, do të garantojë dhe do të marrë masa që Enti Zbatues i Projektit të sigurojë që: a) të gjitha shërbimet konsulente në lidhje me asistencën teknike, projektimin dhe zhvillimin e kapaciteteve në kuadër të Projektit, zbatimi i rezultateve të të cilave mund të ketë implikime mjedisore, sociale dhe shëndetësore dhe sigurie, do të ndërmerren vetëm në përputhje me termat e referencës të rishikuara dhe të konsideruara të pranueshme nga Banka; dhe b) këta terma reference kërkojnë që asistenca teknike, projektimi dhe veprimtaritë e zhvillimit të kapaciteteve të marrin parasysh kërkesat e standardeve, politikave dhe procedurave të zbatueshme sociale dhe mjedisore të Bankës në fuqi në atë kohë dhe do të kërkojnë asistencën teknike, projektimin dhe veprimtaritë për zhvillimin e kapaciteteve për të marrë parasysh kërkesat e standardeve, politikave dhe procedurave në fjalë.

Seksioni II. Monitorimi, Raportimi dhe Vlerësimi i Projektit

Raportet e Projektit

Përfituesi, nëpërmjet MIE-s, do të garantojë që çdo Raport i Projektit t'i dorëzohet Bankës jo më vonë se dyzet e pesë ditë pas përfundimit të çdo semestri kalendarik, duke përfshirë semestrin kalendarik.

Seksioni III. Tërheqja e të Ardhurave nga Granti

A. Të përgjithshme

1. Përfituesi mund të tërheqë të ardhurat e Grantit në përputhje me dispozitat e: a) nenit III të Kushteve Standarde; dhe b) këtij Seksioni; për të financuar Shpenzimet e Pranueshme në shumën e alokuar dhe, nëse është e zbatueshme, deri në përqindjen e caktuar kundrejt çdo kategorie të tabelës së mëposhtme:

Kategoria	Shuma e Grantit të Alokuar (shprehur në USD)	Përqindja e shpenzimeve që duhen financuar (përfshirë taksat)
1. Mallra, shërbime konsulence, shërbime jokonsulence, trajnime dhe kosto operative	3.000.000	100%
SHUMA TOTALE	3.000.000	

B. Kushtet e Tërheqjes; Periudha e Tërheqjes

1. Pavarësisht nga dispozitat e pjesës A të këtij seksioni, nuk do të kryhet asnjë tërheqje:

a) për pagesat e kryera para Datës së Nënshkrimit; përveç rastit kur tërheqjet deri në një shumë totale që nuk kalon 600,000 dollarë mund të bëhen për pagesat e kryera para Datës së Nënshkrimit, por në ose pas 12 (dymbëdhjetë) muajve para Datës së Nënshkrimit, për shpenzimet e pranueshme sipas kategorisë 1; ose

b) për pagesat e kryera për të financuar çdo veprimtari të Projektit që Banka ka financuar ose ka rënë dakord të financojë sipas Marrëveshjes së Huas.

2. Data e Mbylljes është 31 dhjetor 2025.

SHTOJÇË

Përkufizime

1. “AKUM” nënkupton Agjencinë Kombëtare Shqiptare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, të krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 11 korrik 2018, nën varësinë e MIE-s.

2. “Legjislacioni i AKUM-it” nënkupton vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 11 korrik 2018, ose çdo instrument tjetër përkatës themelimi ose regjistrimi, çdo legjislacion, urdhër qeveritar, rregullore ose marrëveshje përkatëse që krijon AKUM dhe/ose ndikon në aftësinë e AKUM-it për të përmbushur ndonjë nga detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje, prezantohet, ndryshohet, pezullohet, shfuqizohet ose anulohet sipas mendimit të Bankës, për të ndikuar materialisht dhe negativisht në aftësinë e AKUM-it në përmbushjen e ndonjë prej detyrimeve sipas Programit.

3. “Plan Vjetor Pune dhe Buxheti” nënkupton “Planin Vjetor të Punës dhe Buxhetin”, i cili nënkupton planin vjetor të punës dhe buxhetin për projektin që do të përgatitet nga Përfituesi dhe do të miratohet nga Shoqata në përputhje me seksionin I.C, të skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

4. “Udhëzues kundër Korrupsionit” nënkupton, për qëllimet e paragrafit 2 të shtojcës së Kushteve Standarde, “Udhëzuesit për Parandalimin dhe Luftimin kundër Mashtrimit dhe Korrupsionit në Projektet e Financuara nga Huat e BNRZH-së dhe kreditë dhe grantet e IDA-së”, datë 15 tetor 2006 dhe të rishikuar në janar 2011 dhe nga 1 korriku 2016.

5. “Kategori” nënkupton një kategori të përcaktuar në tabelën në seksionin III. A të skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

6. “Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social” ose “ESCP” nënkupton planin e menaxhimit mjedisor dhe angazhimit social për projektin, datë 7 shkurt 2022, siç mund të ndryshohet herë pas here, në përputhje me dispozitat e tij, i cili përcakton masat dhe veprimet materiale që Përfituesi do të kryejë ose do të marrë masa që të kryhen në mënyrë që të trajtohen rreziqet dhe ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale të Projektit, duke përfshirë afatet kohore të veprimeve dhe masave, organizimet institucionale, të personelit, trajnimit, monitorimit dhe raportimit, si dhe çdo instrument mjedisor dhe social që do të përgatitet në bazë të tyre.

7. “Standardet Mjedisore dhe Sociale” ose “ESS” nënkupton bashkërisht: i. “Standardin Mjedisor dhe Social 1: Vlerësimin dhe Menaxhimin e Rreziqeve dhe Ndikimeve Mjedisore dhe Sociale”; ii. “Standardin Mjedisor dhe Social 2: Puna dhe Kushtet e Punës”; iii. “Standardin Mjedisor dhe Social 3: Efikasiteti i Burimeve dhe Parandalimi dhe Menaxhimi i Ndotjes”; Standardin Mjedisor dhe Social 4: Shëndeti dhe Siguria në Komunitet”; v. “Standardin Mjedisor dhe Social 5: Blerja e tokës, Kufizimet në Përdorimin e Tokës dhe Rivendosja e Pavullnetshme”; vi. “Standardin Mjedisor dhe Social 6;

Mbrojtja e Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Qëndrueshëm i Burimeve të Gjalla Natyrore”; vii. “Standardin Mjedisor dhe Social 7: Komunitetet lokale tradicionale të Popujve Indigjenë/Nënsahariane të Privuar Historikisht”; viii. “Standardin Mjedisor dhe Social 8: Trashëgimia Kulturore”; vii. “Standardin Mjedisor dhe Social 9: Ndërmjetësit Financiarë”; x. “Standardin Mjedisor dhe Social 10: Angazhimi i Palëve të interesuara dhe Zbulimi i Informacionit”; në fuqi më 1 tetor 2018, siç është publikuar nga Banka.

8. “Njësi e Qeverisjes Vendore” nënkupton një zonë të qeverisjes vendore, siç përcaktohet në ligjin nr. 115, 2014, “Për Ndarjen Administrative-Territoriale të Njërive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”.

9. “Marrëveshje Huaje” nënkupton marrëveshjen e huas ndërmjet Përfituesit dhe Bankës për Programin, siç një marrëveshje e tillë mund të ndryshohet herë pas here. “Marrëveshja e Huas” përfshin të gjitha shtojcat, skedulet dhe marrëveshjet plotësuese të kësaj marrëveshjeje.

10. “MIE” nënkupton Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë së Përfituesit ose çdo pasues të saj.

11. “Operacion” nënkupton Programin dhe Projektin.

12. “Kostoja Operative” nënkupton shpenzimet shtesë në zbatim, bazuar në Planet Vjetore të Punës dhe Buxhetet e miratuara nga Banka, për llogari të zbatimit, menaxhimit dhe monitorimit dhe vlerësimit të Projektit, duke përfshirë kostot e arsyeshme për shërbimet komunale dhe furnizimet, tarifat bankare, komunikimet, funksionimin, mirëmbajtjen dhe sigurimin e automjeteve, marrjen me qira të hapësirave për zyra, ndërtesat dhe mirëmbajtjen e pajisjeve, shpenzimet e medias lidhur me ndërgjegjësimin e publikut, udhëtimin dhe mbikëqyrjen dhe pagat e personelit me kontratë dhe të përkohshëm, por duke përjashtuar pagat, tarifat, honoraret dhe shpërblimet e anëtarët e shërbimit civil të Përfituesit.

13. “NJKP” nënkupton Njësinë e Koordinimit të Projektit, të referuar në Seksionin I.A.2 të skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

14. “Marrëveshje Performance” nënkupton marrëveshjen e përcaktuar në skedulin 2, Seksioni I. B të Marrëveshjes së Huas.

15. “NJMP” nënkupton Njësinë e Monitorimit të Projektit të referuar në Seksionin I.A.1 të skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.
16. “Rregullore Prokurimi” nënkupton, për qëllimet e paragrafit 20 të shtojcës së Kushteve Standarde, “Rregulloret e Prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit IPF”, nëntor 2020.
17. “Program” nënkupton grupin e veprimtarive të programit të përshkruara në skedulin 1 të Marrëveshjes së Huas.
18. “Manual Operacional i Programit” nënkupton manualin e miratuar nga Përfituesi në përputhje me seksionin I.C të skedulit 2 të Marrëveshjes së Huas.
19. “Ent Zbatues i Projektit” nënkupton AKUM-in.
20. “Manual Operacional i Projektit” nënkupton manualin e përmendur në seksionin I.B të skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.
21. “Datë nënshkrimi” nënkupton datën më të vonë nga dy datat kur Përfituesi dhe Banka nënshkruan këtë Marrëveshje dhe ky përkufizim zbatohet për të gjitha referencat për “datën e Marrëveshjes së Grantit” në Kushtet Standarde.
22. “Kushte standarde” nënkupton “Kushtet standarde të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim për Financimin e Granteve të Krijuara nga Banka nga Fondet e Mirëbesimit”, datë 25 shkurt 2019.
23. “Trajnim” nënkupton koston e arsyeshme të trajnimit, sipas Projektit, bazuar në Planet Vjetore të Punës dhe Buxhetet, duke përfshirë kostot që lidhen me seminarët, *workshop*-et, konferencat, udhëtimet dhe shpenzimet e jetesës për pjesëmarrësit në trajnim, shërbimet e trajnerëve, marrjen me qira të objekteve të trajnimit, përgatitjen dhe riprodhimin e materialeve të trajnimit dhe veprimtari të tjera që lidhen drejtpërdrejt me përgatitjen dhe zbatimin e kursit.
24. “UK” nënkupton ujësjellës-kanalizimet.

POLITIKA E BANKËS
KUSHTET STANDARDE PËR FINANCIMIN ME GRANT TË DHËNË NGA BANKA
NGA FONDET E BESIMIT (2019)

Akresi i Bankës në Përcaktimin e Politikave të Informacionit Publik

Numri i katalogut
LEG5.06-POL.120

Data e lëshimit
29 mars 2019

Data e hyrjes në fuqi
29 mars 2019

Përmbajtja
Kushtet Standarde për Financimin me Grant të dhënë nga Banka nga Fondet e Besimit (2019)

E zbatueshme për
BNRZH, IDA

Lëshuesi
Zëvendës-president i Lartë dhe Këshilltar i Përgjithshëm, LEGVP

Sponsor
Këshilltari Kryesor, LEGOP

**BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM DHE
ASOCIACIONI NDËRKOMBËTAR I ZHVILLIMIT
KUSHTET STANDARDE PËR FINANCIMIN ME GRANT TË DHËNË NGA
BANKA NGA FONDET TË BESIMIT**

Datë 25 shkurt 2019

Përmbajtja

Neni I. Dispozitat hyrëse

Seksioni 1.01. Zbatimi i Kushteve Standarde

Seksioni 1.02. Mospërputhja me Marrëveshjen e Grantit

Seksioni 1.03. Përkufizimet

Seksioni 1.04. Referencat, Titujt

NENI II. Ekzekutimi i Projektit

Seksioni 2.01. Ekzekutimi i Projektit në Përgjithësi

Seksioni 2.02. Sigurimi

Seksioni 2.03. Marrja e Tokës

Seksioni 2.04. Përdorimi i Mallrave, Punimeve dhe Shërbimeve; Mirëmbajtja e Objekteve

Seksioni 2.05. Planet; Dokumente; Të dhënat

Seksioni 2.06. Monitorimi, Raportimi dhe Vlerësimi i Projektit

Seksioni 2.07. Menaxhimi Financiar; Pasqyrat Financiare; Kontrollet

Seksioni 2.08. Bashkëpunimi dhe Konsultimi

Seksioni 2.09. Vizibiliteti dhe Vizitat

Seksioni 2.10. Zona e Diskutueshme

Seksioni 2.11. Prokurimi

Seksioni 2.12. AntiKorrupsioni

NENI III. Tërheqjet

Seksioni 3.01. Llogaria e Grantit; Tërheqjet në Përgjithësi; Valuta e Tërheqjeve

Seksioni 3.02. Mungesa e Financimit

Seksioni 3.03. Angazhimi i veçantë nga Banka

Seksioni 3.04. Aplikimet për Tërheqje ose për Angazhime të Veçanta

Seksioni 3.05. Llogaritë e Përcaktuara

Seksioni 3.06. Shpenzimet e Pranueshme

Seksioni 3.07. Taksat e Financimit

Seksioni 3.08. Alokimi i Shumave të Grantit

NENI IV. Anulimi; Pezullimi; Rimbursimi

Seksioni 4.01. Anulimi nga Përfituesi

Seksioni 4.02. Pezullimi nga Banka

Seksioni 4.03. Anulimi nga Banka

Seksioni 4.04. Shumat sipas Angazhimit të Veçantë të Pandikuar

Seksioni 4.05. Rimbursimi i Grantit

Seksioni 4.06. Efektiviteti i Vazhdueshëm

NENI V. Zbatueshmëria; Arbitrazhi

Seksioni 5.01. Zbatueshmëria

Seksioni 5.02. Mosushtrimi i të drejtave

Seksioni 5.03. Arbitrazhi

NENI VI. Hyrja në Fuqi; përfundimi

Seksioni 6.01. Hyrja në Fuqi

Seksioni 6.02. Përfundimi

Neni VII. Të ndryshme

Seksioni 7.01. Ekzekutimi i Marrëveshjeve të Grantit; njoftimet dhe kërkesat

Seksioni 7.02. Veprimi në emër të përfituesit
Seksioni 7.03. Provat e autoritetit
Seksioni 7.04. Nxjerrja e Informacionit
SHTOJCA

Neni I **Dispozitat hyrëse**

Seksioni 1.01. *Zbatimi i Kushteve Standarde*

Këto Kushte Standarde përcaktojnë termat dhe kushtet e zbatueshme në mënyrë të përgjithshme për grantet e bëra nga BNRZH-JA ose IDA-ja nga fondet e besimit. Ato zbatohen në masën e specifikuar në Marrëveshjen e Grantit.

Seksioni 1.02. *Mospërputhja me Marrëveshjen e Grantit*

Nëse ndonjë dispozitë e Marrëveshjes së Grantit nuk është në pajtim me një dispozitë të këtyre Kushteve Standarde, dispozita e Marrëveshjes së Grantit do të mbizotërojë.

Seksioni 1.03. *Përkufizimet*

Termet me shkronjë kapitale të përdorura në këto Kushte Standarde kanë kuptimet e përcaktuara në shtojcë.

Seksioni 1.04. *Referencat; Titujt*

Referencat në këto Kushte Standarde për nenet, seksionet dhe shtojcën janë për nenet dhe seksionet dhe shtojcën e këtyre Kushteve Standarde. Titujt e neneve, seksioneve, shtojcës dhe tabela e përmbajtjes janë futur në këto Kushte Standarde vetëm për referencë dhe nuk do të merren parasysh gjatë interpretimit të këtyre Kushteve Standarde.

Neni II **Ekzekutimi i Projektit**

Seksioni 2.01. *Ekzekutimi i Projektit në Përgjithësi*

Përfituesi do të sigurojë, që:

a) Projekti është zbatuar: i. me kujdesin dhe efikasitetin e duhur; ii. në përputhje me standardet dhe praktikat e duhura administrative, teknike, financiare, ekonomike, mjedisore dhe sociale; dhe iii. në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Grantit, duke përfshirë këto Kushte Standarde; dhe

b) fondet, objektet, shërbimet dhe burimet e tjera që kërkohen për Projektin sigurohen menjëherë sipas nevojës.

Seksioni 2.02. *Sigurimi*

Përfituesi do të sigurojë që është bërë dispozitë e duhur për sigurimin e ndonjë malli që kërkohet për Projektin dhe që do të financohet nga të ardhurat e Grantit, ndaj rreziqeve lidhur me blerjen, transportimin dhe dorëzimin e mallrave në vendin e tyre të përdorimit ose instalimit. Çdo zhdëmtim për një sigurim të tillë do të paguhet në një monedhë të përdorshme lirisht për të zëvendësuar ose riparuar mallra të tilla.

Seksioni 2.03. *Marrja e Tokës*

Përfituesi do të sigurojë që ndërmerren të gjitha veprimet për të marrë, siç dhe kur është e nevojshme, të gjithë tokën dhe të drejtat për tokën, që kërkohen për të zbatuar Projektin, dhe do t'i sigurojë Bankës menjëherë, me kërkesën e saj, prova të pranueshme për Bankën se toka dhe të drejtat janë në dispozicion për Projektin.

Seksioni 2.04. *Përdorimi i Mallrave, Punimeve dhe Shërbimeve; Mirëmbajtja e Objekteve*

Përfituesi do të sigurojë që:

a) përveç nëse Banka bie dakord ndryshe, të gjitha mallrat, punimet dhe shërbimet e financuara nga të ardhurat e Grantit përdoren ekskluzivisht për qëllimet e Projektit; dhe

b) të gjitha pajisjet e rëndësishme për Projektin operohen dhe mirëmbahen në çdo kohë dhe si duhet, dhe të gjitha riparimet dhe rinovimet e domosdoshme të objekteve të tilla bëhen menjëherë, siç nevojitet.

Seksioni 2.05. Planet; Dokumentet; Të dhënat

Përfituesi do të sigurojë që:

a) të gjitha planet, skedulet, specifikimet, raportet dhe dokumentet e kontratës për Projektin i paraqiten Bankës menjëherë me kërkesën e saj, në detaje të tilla siç Banka do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme;

b) të dhënat mbahen si duhet, për të shënuar ecurinë e Projektit (duke përfshirë koston e tij dhe përfitimet që do të vijnë prej tij), për të identifikuar shpenzimet e Përshtatshme të financuara nga të ardhurat e Grantit dhe për të zbuluar përdorimin e tyre në Projekt, dhe këto të dhëna i dorëzohen Bankës menjëherë me kërkesën e saj;

c) të gjitha të dhënat që vërtetojnë shpenzimet në bazë të Projektit ruhen të paktën: i. 2 (dy) vjet pas Datës së Mbylljes; ose ii. nëse Banka kërkon auditime të Pasqyrave Financiare të Përfituesit në përputhje me seksionin 2.07(b) më poshtë, më vonë: A. 1 (një) vit pasi Banka ka marrë Pasqyrat Financiare të audituara që mbulojnë periudhën gjatë së cilës u bë tërheqja e fundit nga Llogaria e Grantit; dhe B. 2 (dy) vjet pas Datës së Mbylljes; dhe

d) Banka mund të shqyrtojë këto të dhëna dhe i jepet i gjithë informacioni në lidhje me këto të tilla, siç mund të kërkojë me arsye.

Seksioni 2.06. Monitorimi, Raportimi dhe Vlerësimi i Projektit

Përfituesi do të sigurojë:

a) mirëmbajtjen e politikave dhe procedurave të duhura, për t'i mundësuar atij të monitorojë dhe vlerësojë në mënyrë të vazhdueshme, në përputhje me treguesit e pranueshëm nga Banka, ecurinë e Projektit dhe arritjen e objektivave të tij; dhe

b) përgatitjen e raporteve periodike ("Raportet e Projektit"), në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, duke integruar rezultatet e veprimtarive të tilla të monitorimit dhe vlerësimit dhe duke përcaktuar masat e rekomanduara nga Përfituesi për të siguruar zbatimin e vazhdueshëm efikas dhe efektiv të Projektit, dhe për të arritur objektivat e Projektit. Përfituesi do të sigurojë se çdo Raport i Projektit i dorëzohet menjëherë Bankës pas përgatitjes së Raportit, dhe i ofron Bankës një mundësi të arsyeshme për të shkëmbyer këndvështrime me Përfituesin mbi një raport të tillë, dhe më pas të zbatojë masa të tilla të rekomanduara, duke marrë parasysht këndvështrimet e Bankës për çështjen.

c) përveç nëse Banka mund të përcaktojë ndryshe në mënyrë të arsyeshme, përgatitja dhe pajisja e Bankës jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj pas Datës së Mbylljes me: i. një raport, me objekt të tillë dhe detaje të tilla siç Banka do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për ekzekutimin e Projektit, realizimin nga Përfituesi dhe Banka të detyrimeve të tyre përkatëse sipas Marrëveshjeve të Grantit dhe përmbushjen e qëllimeve të Financimit; dhe ii. një plan të hartuar për të siguruar qëndrueshmërinë e arritjeve të Projektit.

Seksioni 2.07. Menaxhimi Financiar; Pasqyrat Financiare; Kontrollat

Përfituesi do të sigurojë që:

a) mirëmbahet një sistem i menaxhimit financiar dhe përgatiten pasqyrat financiare ("Pasqyrat Financiare"), në përputhje me standardet e zbatuara të kontabilitetit, të pranueshme nga Banka, në një mënyrë të përshtatshme për të pasqyruar veprimtaritë, burimet dhe shpenzimet, në lidhje me Projektet, siç mund të specifikohet më tej në udhëzimet shtesë, që Banka mund të specifikojë herë pas here me një njoftim për Përfituesin.

b) nëse kërkohet në këtë mënyrë në përputhje me dispozitat e udhëzimeve shtesë:

i. Pasqyrat Financiare auditohen periodikisht nga auditorë të pavarur të pranueshëm nga Banka, në përputhje me standardet e auditimit të zbatuara vazhdimisht të pranueshme nga Banka;

ii. jo më vonë se data e specifikuar në udhëzimet shtesë, Bankës i dorëzohen Pasqyrat Financiare të audituara në mënyrë të tillë, dhe informacione të tilla të tjera në lidhje me Pasqyrat Financiare të audituara dhe auditorë të tillë, siç mund të kërkojë Banka herë pas here me arsye;

iii. Pasqyrat Financiare të audituara bëhen të disponueshme për publikun në kohën e duhur dhe në një mënyrë të pranueshme nga Banka; dhe

iv. nëse kërkohet nga Banka, raportet financiare të përkohshme të paaudituar për Projektin, në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën dhe siç specifikohet më tej në udhëzimet shtesë, siç mund të specifikojë Banka herë pas here me njoftim për Përfituesin, i jepen Bankës në mënyrë periodike.

Seksioni 2.08. *Bashkëpunimi dhe Konsultimi*

Përfituesi dhe Banka do të bashkëpunojnë plotësisht për të siguruar që qëllimet e Grantit dhe objektivat e Projektit do të përmbushen. Për këtë qëllim, gjatë gjithë zbatimit të Projektit dhe për një periudhë prej 10 (dhjetë) vjetësh më pas, Banka dhe Përfituesi:

a) herë pas here, me kërkesë të ndonjërit prej tyre, shkëmbejnë këndvështrime mbi Projektin, Grantin dhe realizimin e detyrimeve të tyre përkatëse, sipas Marrëveshjes së Grantit dhe i japin palës tjetër të gjitha informacionet e tilla, në lidhje me këto çështje, siç do të kërkojë me arsye; dhe

b) informojnë menjëherë palën tjetër për çdo kusht që ndërhyt ose kërcënon të ndërhyjë në çështje të tilla.

Seksioni 2.09. *Vizibiliteti dhe vizitat*

Përfituesi:

a) siguron që janë marrë të gjitha masat, që Banka në mënyrë të arsyeshme mund të kërkojë për të identifikuar publikisht donatorin (donatorët) për fondin e mirëbesimit që mbështet Projektin; dhe

b) gjatë gjithë zbatimit të Projektit dhe për një periudhë 10- vjeçare (dhjetëvjeçare) më pas:

i. nëse është Vendi Anëtar, mundëson për përfaqësuesit e Bankës dhe, nëse kërkohet nga Banka, për përfaqësuesit e donatorit (donatorëve), të vizitojnë ndonjë pjesë të territorit të tij për qëllime që lidhen me Grantin;

ii. nëse nuk është Vendi Anëtar, merr të gjitha masat që duhet të merren nga ana e tij për të mundësuar për përfaqësuesit e Bankës dhe, nëse kërkohet nga Banka, për përfaqësuesit e donatorit (donatorëve), të vizitojnë ndonjë pjesë të territorit të Vendi Anëtar për qëllime që lidhen me Grantin; dhe

iii. mundëson për përfaqësuesit e Bankës dhe nëse kërkohet nga Banka, për përfaqësuesit e donatorit (donatorëve): A. të vizitojnë çdo objekt dhe vendpunim të përfshirë në Projekt; dhe B. të kontrollojnë mallrat e financuara nga të ardhurat e Grantit, dhe çdo dokument që lidhet me kryerjen e detyrimeve të tij sipas Marrëveshjes së Grantit.

Seksioni 2.10. *Zona e Diskutueshme*

Në rast se Projekti është në një zonë që është ose bëhet e diskutueshme, as financimi i Projektit të Bankës, as ndonjë përcaktim apo referencë e një zone të tillë në Marrëveshjen e Grantit, nuk ka për qëllim të përbëjë një gjykim nga ana e Bankës, sa i përket statusit ligjor ose tjetër të një zone të tillë ose të cenojë përcaktimin e ndonjë kërkesë në lidhje me atë zonë.

Seksioni 2.11. *Prokurimi*

Të gjitha mallrat, punimet dhe shërbimet e kërkuara për Projektin dhe që do të financohen nga të ardhurat e Grantit do të prokurohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara ose të referuara në Rregulloret e Prokurimit dhe dispozitat e Planit të Prokurimit.

Seksioni 2.12. *Antikorrupsioni*

Përfituesi do të sigurojë që Projekti realizohet në përputhje me dispozitat e Udhëzimeve Antikorrupsion.

Seksioni 3.01. *Llogaria e Grantit; Tërheqjet në Përgjithësi; Valuta e Tërheqjeve*

a) Banka do të kreditojë shumën e Grantit në valutën e emërimit të Grantit në Llogarinë e Grantit.

b) Përfituesi mund të kërkojë herë pas here tërheqje të shumave të Grantit nga Llogaria e Grantit, në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Grantit dhe udhëzime të tilla shtesë, siç mund të specifikojë Banka herë pas here me anë të njoftimi për Përfituesin.

c) Çdo tërheqje e një shume të Grantit nga Llogaria e Grantit do të bëhet në valutën e emërimit të Grantit për Llogarinë e Grantit. Banka, me kërkesë dhe duke vepruar si një agjent i Përfituesit, dhe në termat dhe kushtet që Banka do të përcaktojë, mund të blejë me valutën e tërhequr nga Llogaria e Grantit valuta të tjera që Përfituesi do të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të përmbushur pagesat për Shpenzimet e Pranueshme. Kurdoherë që do të jetë e nevojshme për qëllimin e Marrëveshjes së Grantit ose këtyre Kushteve Standarde për të përcaktuar vlerën e një valute në kushtet e një valute tjetër, një vlerë e tillë do të përcaktohet në mënyrë të arsyeshme nga Banka.

Seksioni 3.02. *Mungesa e Financimit*

Pavarësisht nga dispozitat e seksionit 3.01, asnjë tërheqje nuk do të bëhet nëse, si rezultat i një tërheqjeje të tillë, shumata totale e Grantit të tërhequr nga Llogaria e Grantit do të tejkalonte shumën në dispozicion për Bankën nga burimet e fondit të mirëbesimit të siguruar nga donatorët për qëllimet e Grantit. Përfituesi do të mbajë rrezikun e ndonjë mungese të tillë të financimit dhe Banka nuk do të ketë asnjë përgjegjësi ndaj Përfituesit ose ndaj ndonjë pale të tretë, në lidhje me çdo shpenzim ose detyrim të shtuar në lidhje me Marrëveshjen e Grantit që tejkalon shumën e vënë në dispozicion për Bankën për qëllimet e Grantit.

Seksioni 3.03. *Angazhimi i veçantë nga Banka*

Me kërkesën e Përfituesit dhe në terma dhe kushte të tilla që Përfituesi dhe Banka do të bien dakord, Banka mund të hyjë në angazhime të veçanta me shkrim për të paguar shumat për Shpenzimet e Pranueshme, pavarësisht nga ndonjë pezullim ose anulim i mëvonshëm i një shume të Grantit (“Angazhimi i Veçantë”).

Seksioni 3.04. *Aplikime për Tërheqje ose për Angazhime të Veçanta*

a) Kur Përfituesi dëshiron të tërheqë një shumë nga Llogaria e Grantit ose të kërkojë nga Banka që të hyjë në një Angazhim të Veçantë, Përfituesi do t’i dorëzojë Bankës menjëherë një kërkesë me shkrim për qëllimin, në atë formë dhe përmbajtje siç do të kërkojë Banka në mënyrë të arsyeshme.

b) Përfituesi do t’i paraqesë Bankës dëshmi të pranueshme për Bankën të autoritetit të personit ose personave të autorizuar për të nënshkruar aplikime të tilla dhe nënshkrimin model të vërtetuar të secilit person të tillë.

c) Përfituesi do t’i paraqesë Bankës dokumente të tilla dhe prova të tjera në mbështetje të secilës kërkesë të tillë, siç Banka do të kërkojë me arsye, para ose pasi Banka të ketë lejuar çdo tërheqje të kërkuar në aplikim.

d) Çdo kërkesë e tillë, dokumentet shoqëruese dhe provat e tjera do të jenë të mjaftueshme në formë dhe përmbajtje për të bindur Bankën që Përfituesi ka të drejtë të tërheqë një shumë të tillë nga Llogaria e Grantit dhe se kjo shumë do të përdoret vetëm për qëllimet e specifikuar në Marrëveshjen e Grantit.

e) Banka do të paguajë shumat e tërhequra nga Përfituesi nga Llogaria e Grantit vetëm për ose me urdhër të Përfituesit.

Seksioni 3.05. *Llogaritë e Përcaktuara*

a) Përfituesi mund të hapë dhe mbajë një ose më shumë llogari të përcaktuara në të cilat Banka mund, me kërkesë të Përfituesit, të depozitojë shumat e tërhequra nga Llogaria e Grantit si paradhënie për qëllimet e Projektit. Të gjitha llogaritë e përcaktuara do të hapen në një institucion financiar të pranueshëm për Bankën, dhe me termat dhe kushtet e pranueshme për Bankën.

b) Depozitimet dhe pagesat nga ndonjë llogari e tillë e caktuar do të bëhen në përputhje me Marrëveshjen e Grantit dhe udhëzime të tjera shtesë që Banka mund të specifikojë herë pas here me njoftim për Përfituesin, duke përfshirë Udhëzimet e Disbursimit të Bankës Botërore për Projektet. Banka, në përputhje me Marrëveshjen e Grantit dhe udhëzimet e tilla, mund të ndalojë së bëri depozitime në ndonjë llogari të tillë pasi të dërgohet njoftimi për Përfituesin. Në një rast të tillë, Banka do të njoftojë Përfituesin për procedurat që do të përdoren për tërheqjet vijuese nga Llogaria e Grantit.

Seksioni 3.06. *Shpenzimet e Pranueshme*

Shpenzimet e Pranueshme që duhet të financohen nga të ardhurat e Grantit, përveç nëse parashikohet ndryshe në Marrëveshjen e Grantit, plotësojnë kërkesat e mëposhtme (“Shpenzimet e Pranueshme”):

a) pagesa është për koston e arsyeshme të aktiviteteve të Projektit që përmbushin kërkesat e Marrëveshjes përkatëse të Grantit;

b) pagesa nuk është e ndaluar nga një vendim i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara i marrë sipas kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara; dhe

c) pagesa është bërë në ose pas datës së Marrëveshjes së Grantit, dhe përveç nëse Banka mund të bie dakord ndryshe, është për shpenzimet e bëra në ose para datës së mbylljes.

Seksioni 3.07. *Taksat e Financimit*

Përdorimi i të ardhurave të Grantit për të paguar Taksat e mbledhura nga, ose në territorin e Vendit Anëtar në ose në lidhje me Shpenzimet e Pranueshme, ose në importin, prodhimin, prokurimin ose furnizimin e tyre, nëse lejohet në përputhje me Marrëveshjen e Grantit, i nënshtrohet politikës së Bankës për të kërkuar ekonomi dhe efikasitet në përdorimin e të ardhurave të Granteve të saj. Për këtë qëllim, nëse Banka në ndonjë kohë të caktuar, përcakton se shuma e ndonjë Takse të tillë është e tepërt, ose që një Taksë e tillë është diskriminuese ose ndryshe e paarsyeshme, Banka, me njoftim për Përfituesin, mund të rregullojë përqindjen e Shpenzimeve të tilla të Pranueshme që do të financohen nga të ardhurat e Grantit.

Seksioni 3.08. *Alokimi i shumave të grantit*

Nëse Banka vendos në mënyrë të arsyeshme se për të përmbushur qëllimet e Grantit është e përshtatshme të rialokojë shumat e Grantit midis kategorive të tërheqjes, modifikojë kategoritë ekzistuese të tërheqjes ose modifikojë përqindjen e shpenzimeve që do të financohen nga Banka sipas secilës kategori të tërheqjes, Banka, pas konsultimit me Përfituesin, mund të bëjë modifikime të tilla dhe do të njoftojë Përfituesin në përputhje me rrethanat.

Neni IV

Anulimi; Pezullimi; Rimbursimi

Seksioni 4.01. *Anulimi nga Përfituesi*

Përfituesi, me një njoftim për Bankën, mund të anulojë çdo shumë të patërhequr të Grantit, me përjashtim që Përfituesi nuk mund të anulojë ndonjë shumë të tillë që i nënshtrohet një Angazhimi të Veçantë.

Seksioni 4.02. *Pezullimi nga Banka*

Banka, me një njoftim për Përfituesin, mund të pezullojë, tërësisht ose pjesërisht, të drejtën e Përfituesit për të kryer tërheqje nga Llogaria e Grantit, nëse ndonjë nga ngjarjet e mëposhtme ndodh dhe po vazhdon. Një pezullim i tillë do të vazhdojë derisa ngjarja (ose ngjarjet) të cilat kanë shkaktuar pezullim të ketë pushuar (ose kanë pushuar) të ekzistojë, përveç nëse Banka ka njoftuar Përfituesin se është rivendosur kjo e drejtë për të kryer tërheqje.

a) *Ndërhyrja.* Nëse Granti i është dhënë një Përfituesi i cili nuk është Vendi Anëtar, Vendi Anëtar ka: i. marrë ose lejuar të ndërmerret çdo veprim që mund të parandalojë ose ndërhyjë në ekzekutimin e Projektit ose përmbushjen nga Përfituesi të detyrimeve të tij sipas Marrëveshjes së Grantit; ose ii. nuk ka arritur të sigurojë një mundësi të arsyeshme për përfaqësuesit e Bankës që të vizitojnë ndonjë pjesë të territorit të tij për qëllime që lidhen me Grantin ose Projektin.

b) *Mospërbushja e Performancës*. Përfituesi nuk ka përbushur ndonjë detyrim sipas Marrëveshjes së Grantit.

c) *Mashtrimi dhe Korrupsioni*. Në çdo kohë, Banka përcakton që çdo përfaqësues i Përfituesit (ose i Vendi Anëtar, nëse Përfituesi nuk është Vendi Anëtar, ose ndonjë përfitues tjetër i ndonjë prej të ardhurave të Grantit) është përfshirë në praktika korruptive, mashtruese, shtrënguese ose bashkëpunuese, në lidhje me përdorimin e të ardhurave të Grantit, pa marrjen nga ana e Përfituesit (ose Vendi Anëtar ose ndonjë përfituesi tjetër të tillë) të masave në kohë dhe të përshtatshme, të pranueshme për Bankën për të trajtuar praktika të tilla kur ato ndodhin.

d) *Pezullimi i tërthortë*. BNRZH ose IDA kanë pezulluar tërësisht ose pjesërisht të drejtën e Përfituesit (ose të Vendi Anëtar, nëse Përfituesi nuk është Vendi Anëtar) për të kryer tërheqje sipas ndonjë marrëveshjeje me BNRZH-në ose me IDA-n, për shkak të pamundësisë nga Përfituesi (ose nga Vendi Anëtar) për të përbushur ndonjë nga detyrimet e tij sipas marrëveshjes së tillë ose ndonjë marrëveshjeje tjetër me BNRZH-në ose IDA-n.

e) *Situata e jashtëzakonshme*. Si rezultat i ngjarjeve që kanë ndodhur pas datës së Marrëveshjes së Grantit, ka lindur një situatë e jashtëzakonshme e cila e bën të pamundur që Projekti të mund të kryhet ose Përfituesi të jetë i aftë të kryejë detyrimet e tij sipas Marrëveshjes së Grantit.

f) *Keqpërfaqësimi*. Një përfaqësim i kryer nga Përfituesi në ose në përputhje me Marrëveshjen e Grantit ose çdo përfaqësim ose deklaratë e dhënë nga Përfituesi dhe që synon të mbështetet nga Banka në dhënien e Grantit, ishte i pasaktë në ndonjë aspekt material.

g) *Delegimi i Detyrimeve; Disponimi i Aseteve*. Përfituesi (ose ndonjë subjekt tjetër përgjegjës për zbatimin e ndonjë pjese të Projektit) pa miratimin e Bankës:

i. ka deleguar caktuar ose transferuar, tërësisht ose pjesërisht, ndonjë nga detyrimet e tij që lindin ose lidhen në përputhje me Marrëveshjen e Grantit; ose

ii. ka shitur, dhënë me qira, transferuar, deleguar ose disponuar ndryshe ndonjë pronë ose pasuri të financuar tërësisht ose pjesërisht nga të ardhurat e Grantit; me kusht që dispozitat e këtij paragrafi të mos zbatohen në lidhje me transaksionet në rrjedhën e zakonshme të biznesit të cilat, sipas opinionit të Bankës: A. nuk ndikojnë materialisht dhe negativisht në aftësinë e Përfituesit (ose ndonjë subjekti tjetër) për të kryer ndonjë nga detyrimet e tij që lindin ose që lidhen në përputhje me Marrëveshjen e Grantit për të arritur objektivat e Projektit; dhe B. nëse Granti i është dhënë një Përfituesi i cili nuk është Vendi Anëtar, nuk ndikojnë materialisht dhe negativisht në gjendjen financiare ose funksionimin e Përfituesit (ose një subjekti tjetër të tillë).

g) *Anëtarësimi*. Vendi Anëtar: i. është pezulluar nga anëtarësimi në ose nuk është më anëtar i BNRZH-së ose i IDA-s; ose ii. nuk është më anëtar i Fondit Monetar Ndërkombëtar.

b) *Kushti i Përfituesit*

i. Nëse Granti i është dhënë një Përfituesi i cili nuk është Vendi Anëtar:

A. Çdo veprim është ndërmarrë për shpërbërjen, ndërprerjen ose pezullimin e aktiviteteve të Përfituesit (ose të ndonjë subjekti tjetër përgjegjës për zbatimin e ndonjë pjese të Projektit).

B. Përfituesi (ose ndonjë subjekt tjetër përgjegjës për zbatimin e ndonjë pjese të Projektit) ka pushuar së ekzistuari në të njëjtën formë ligjore si ajo mbizotëruese që nga data e Marrëveshjes së Grantit.

ii. Sipas mendimit të Bankës, karakteri juridik, pronësia ose kontrolli i Përfituesit (ose i ndonjë subjekti tjetër përgjegjës për zbatimin e ndonjë pjese të Projektit) ka ndryshuar nga ai mbizotërues në datën e Marrëveshjes së Grantit, që të ndikojë materialisht dhe negativisht në aftësinë e Përfituesit (ose një subjekti tjetër të tillë) për të kryer ndonjë nga detyrimet e tij që lindin ose të lidhura në përputhje me Marrëveshjen e Grantit, ose për të arritur objektivat e Projektit.

i. *Pranueshmëria*

BNRZH-ja ose IDA kanë shpallur Përfituesin (përveç Vendi Anëtar) të papranueshëm për të marrë të ardhura nga çdo financim të bërë nga BNRZH-ja ose IDA, ose ndryshe për të marrë pjesë në përgatitjen ose zbatimin e ndonjë projekti të financuar në tërësi ose pjesërisht nga BNRZH ose IDA, si rezultat i: i. një përcaktimi nga BNRZH-ja ose IDA që Përfituesi ka kryer

veprimtari mashtruese, korruptive, shtrënguese ose bashkëpunuese në lidhje me përdorimin të të ardhurave nga çdo financim të kryer nga BNRZH-ja ose IDA; dhe/ose ii. një deklaratë nga një financues tjetër që Përfituesi nuk ka të drejtë të marrë të ardhura nga ndonjë financim të kryer nga një financues i tillë ose ndryshe për të marrë pjesë në përgatitjen ose zbatimin e ndonjë projekti të financuar tërësisht ose pjesërisht nga një financues i tillë si rezultat i një përcaktimi nga një financues i tillë që Përfituesi të jetë përfshirë në praktika mashtruese, korruptive, shtrënguese ose bashkëpunuese, në lidhje me përdorimin e të ardhurave të çdo financimi të kryer nga një financues i tillë.

k) *Rasti shitesë*. Ka ndodhur çdo ngjarje tjetër e specifikuar në Marrëveshjen e Grantit për qëllimet e këtij Seksioni (“Rasti Shitesë i Pezullimit”).

Seksioni 4.03. *Anulimi nga Banka*

Banka, me njoftim për Përfituesin, mund të përfundojë të drejtën e Përfituesit për të kryer tërheqje në lidhje me një shumë të papaguar të Grantit dhe ta anulojë atë shumë, nëse ndonjë nga ngjarjet e mëposhtme ndodh në lidhje me këtë shumë:

a) *Pezullimi*. E drejta e Përfituesit për të kryer tërheqje nga Llogaria e Grantit është pezulluar në lidhje me çdo shumë të Grantit për një periudhë të vazhdueshme prej tridhjetë ditësh.

b) *Shumat e Pakërkuara*. Banka përcakton, pas konsultimit me Përfituesin, që një shumë e Grantit nuk do të kërkohej për të financuar Shpenzimet e Pranueshme.

c) *Mashtrimi dhe Korruptioni*. Në çdo kohë, Banka përcakton, në lidhje me çdo shumë të të ardhurave të Grantit, se në praktikën korruptive, mashtruese, bashkëpunuese ose shtrënguese janë përfshirë përfaqësuesit e Përfituesit (ose Vendi Anëtar, nëse Përfituesi nuk është Vendi Anëtar, ose ndonjë marrës tjetër i të ardhurave të Grantit), pa marrjen nga Përfituesi (ose Vendi Anëtar ose një marrës tjetër i të ardhurave të Grantit) të veprimeve në kohë dhe të përshtatshme, sipas bindjes së Bankës, për të trajtuar praktika të tilla kur ato ndodhin.

d) *Prokurimi i gabuar*. Në çdo kohë, Banka: i. përcakton që prokurimi i çdo kontrate që do të financohet nga të ardhurat e Grantit është në kundërshtim me procedurat e përcaktuara ose të referuara në Marrëveshjen e Grantit; dhe ii. përcakton shumën e shpenzimeve sipas një kontrate të tillë që përndryshe do të kishte të drejtë për financim nga të ardhurat e Grantit.

e) *Data e Mbylljes*. Pas datës së mbylljes, mbetet një shumë e Grantit e pa tërhequr.

Seksioni 4.04. *Shumat Sipas Angazhimit të Veçantë të Paprekur*

Asnjë anulim ose pezullim nga Banka nuk do të zbatohet për shumën që i nënshtrohen ndonjë Angazhimi të veçantë, përveç siç parashikohet shprehimisht në Angazhimin Special.

Seksioni 4.05. *Rimbursimi i Grantit*

a) Nëse Banka përcakton që një shumë e Grantit është përdorur në një mënyrë që nuk është në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Grantit, Përfituesi, pasi njoftimit nga Banka për Përfituesin, do t’ia kthejë menjëherë shumën e tillë Bankës. Një përdorim i tillë i paqëndrueshëm do të përfshijë, pa kufizim:

i. Përdorimin e kësaj shume për të kryer një pagesë për një shpenzim që nuk është një Shpenzim i Pranueshëm; ose

ii. A. përfshirjen në praktika korruptive, mashtruese, bashkëpunuese ose shtrënguese në lidhje me përdorimin e kësaj shume; ose B. përdorimi i kësaj shume për të financuar një kontratë gjatë prokurimit ose ekzekutimit të së cilës praktikoheshin praktika të tilla nga përfaqësuesit e Përfituesit (ose Vendi Anëtar, nëse Përfituesi nuk është Vendi Anëtar, ose marrës tjetër i shumës së tillë të Grantit), në të dyja rastet ku Përfituesi (ose Vendi Anëtar, ose një përfitues tjetër i tillë) nuk ka marrë veprime të kohë dhe të duhura të pranueshme për bankën për të adresuar praktika të tilla kur ato ndodhin.

b) Përveç nëse Banka mund të përcaktojë ndryshe, Banka do të anulojë të gjitha shumën e rimbursuara në përputhje me këtë seksion.

Seksioni 4.06. *Efektiviteti i Vazhdueshëm*

Pavarësisht nga çdo anulim, pezullim ose rimbursim sipas këtij neni, të gjitha dispozitat e Marrëveshjes së Grantit do të vazhdojnë në fuqi dhe efekt të plotë, përveç siç parashikohet specifikisht në këto Kushte Standarde.

NENI V **Zbatueshmëria; Arbitrazhi**

Seksioni 5.01. *Zbatueshmëria*

Të drejtat dhe detyrimet e Përfituesit dhe Bankës sipas Marrëveshjes së Grantit do të jenë të vlefshme dhe të zbatueshme në përputhje me kushtet e tyre, pavarësisht nga ligji i ndonjë shteti ose nënndarjeje politike të tij në të kundërtën. As Përfituesi dhe as Banka nuk do të kenë të drejtë në ndonjë procedurë sipas këtij neni, për të pohuar ndonjë pretendim se ndonjë dispozitë e këtyre Kushteve Standarde ose të Marrëveshjes së Grantit është e pavlefshme ose e pazbatueshme për shkak të ndonjë dispozite të neneve të BNRZH-së ose IDA-s.

Seksioni 5.02. *Mosushtrimi i të drejtave*

Asnjë vonesë në ushtrimin ose mosveprim në ushtrimin e ndonjë të drejte, kompetence ose mjeti ligjor të akumuluar për çdo palë sipas Marrëveshjes së Grantit pas ndonjë vonese/mospërmbushjeje, nuk do të dëmtojë ndonjë të drejtë, kompetencë ose mjet të tillë ligjor ose nuk do të interpretohet si heqje dorë prej saj ose si pranim i heshtur në një vonesë/mospërmbushje të tillë. Asnjë veprim i një pale të tillë në lidhje me ndonjë mospërmbushje ose pranim të heshtur prej saj në ndonjë vonesë/mospërmbushje, nuk do të ndikojë ose dëmtojë ndonjë të drejtë, kompetencë ose mjet ligjor të një pale të tillë, në lidhje me ndonjë vonesë/mospërmbushje tjetër ose pasuese.

Seksioni 5.03. *Arbitrazhi*

a) Çdo konflikt midis palëve të Marrëveshjes së Grantit dhe çdo pretendim nga ndonjë palë e tillë kundër ndonjë pale tjetër të tillë që lind në bazë të Marrëveshjes së Grantit, të cilat nuk janë zgjidhur me marrëveshje të palët, do të paraqiten në arbitrazh nga një gjykatë arbitrazhi, siç parashikohet më poshtë (“Tribunali i Arbitrazhit”).

b) Palët në një arbitrazh të tillë do të jenë Banka nga njëra anë dhe Përfituesi nga ana tjetër.

c) Tribunali i Arbitrazhit do të përbëhet nga tre arbitra të caktuar si më poshtë: i. një arbitër do të emërohet nga Banka; ii. një arbitër i dytë do të emërohet nga Përfituesi; dhe iii. arbitri i tretë (“Gjykatësi i Arbitrazhit”) do të emërohet me marrëveshje të palëve ose, nëse nuk bien dakord, nga Kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë ose, në pamundësi të emërimit nga Kryetari i lartpërmendur, nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Nëse njëra palë nuk mund të caktojë një arbitër, një arbitër i tillë do të emërohet nga Gjykatësi i Arbitrazhit. Në rast se ndonjë arbitër i caktuar në përputhje me këtë seksion jep dorëheqjen, vdes ose bëhet i paafte për të vepruar, një arbitër pasues do të emërohet në të njëjtën mënyrë siç përshkruhet në këtë seksion për emërimin e një arbitri fillestar dhe një pasues i tillë do të ketë të gjitha kompetencat dhe detyrat e një arbitri të tillë fillestar.

d) Një procedurë arbitrazhi mund të fillohet sipas këtij seksioni pas njoftimit nga pala që fillon një procedurë të tillë për palën tjetër. Ky njoftim do të përmbajë një deklaratë që përcakton natyrën e konfliktit ose pretendimit për t’u paraqitur në arbitrazh, natyrën e kompensimit të kërkuar dhe emrin e arbitrit të caktuar nga pala që fillon një procedim të tillë. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas këtij njoftimi, pala tjetër do t’i njoftojë palës që fillon procedimin, emrin e arbitrit të caktuar nga pala tjetër.

e) Nëse brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve pas njoftimit për fillimin e procedurës së arbitrazhit, palët nuk kanë rënë dakord për një Gjykatë Arbitrazhi, secila palë mund të kërkojë emërimin e një Gjykatësi Arbitrazhi, siç parashikohet në paragrafin “c” të këtij seksioni.

f) Tribunali i Arbitrazhit do të mblidhet në atë kohë dhe vend që përcaktohet nga Gjykatësi i Arbitrazhit. Pas kësaj, Tribunali i Arbitrazhit do të përcaktojë se ku dhe kur do të mblidhet.

g) Tribunali i Arbitrazhit do të vendosë për të gjitha çështjet në lidhje me kompetencën e tij dhe në bazë të dispozitave të këtij seksioni dhe, përveç nëse palët bien dakord ndryshe, përcakton procedurën e tij. Të gjitha vendimet e Tribunalit të Arbitrazhit do të jenë me shumicë votash.

h) Tribunali i Arbitrazhit do t'u sigurojë të gjitha palëve një seancë dëgjimore të ndershme dhe do të japë vendimin e tij me shkrim. Një vendim i tillë mund të jepet në mungesë. Një vendim i nënshkruar nga shumica e Tribunalit të Arbitrazhit do të përbëjë vendimin e Tribunalit të Arbitrazhit. Secilës palë do t'i jepet një kopje e nënshkruar e vendimit. Çdo vendim i tillë i dhënë në përputhje me dispozitat e këtij seksioni do të jetë përfundimtare dhe i detyrueshëm për palët në Marrëveshjen e Grantit. Secila palë do të zbatojë dhe respektojë çdo vendim të tillë të dhënë nga Tribunali i Arbitrazhit në përputhje me dispozitat e këtij seksioni

i) Palët do të përcaktojnë shumën e shpërblimit të arbitrave dhe personave të tjerë që kërkohen për zhvillimin e procedurave të arbitrazhit. Nëse palët nuk bien dakord për një shumë të tillë përpara se të thirret Tribunali i Arbitrazhit, Tribunali i Arbitrazhit do të caktojë shumën që do të jetë e arsyeshme sipas rrethanave. Secila Palë do të paguajë shpenzimet e veta në procedurat e arbitrazhit. Kostot e Tribunalit të Arbitrazhit do të ndahen midis dhe do të mbulohen në mënyrë të barabartë nga palët. Çdo çështje në lidhje me ndarjen e kostove të Tribunalit të Arbitrazhit ose procedurën për pagimin e këtyre kostove, do të përcaktohet nga Tribunali i Arbitrazhit.

j) Dispozitat për arbitrazh të përcaktuara në këtë seksion do të jenë në vend të çdo procedure tjetër për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis palëve të Marrëveshjes së Grantit ose të ndonjë pretendimi nga ndonjë palë e tillë kundër çdo pale tjetër të tillë që lind nën Marrëveshjet e tilla Ligjore.

k) Nëse, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pasi kopjet e vendimit u janë dorëzuar palëve, vendimi nuk është përmbushur, çdo palë mund të: i. regjistrojë vendimin ose të fillojë një procedim për të zbatuar vendimin në ndonjë gjykatë të juridiksionit kompetent kundër ndonjë pale tjetër; ii. zbatojë një vendim të tillë me anë të ekzekutimit; ose iii. të ushtrojë ndonjë mjet tjetër të përshtatshëm ligjor kundër një pale tjetër për zbatimin e vendimit dhe dispozitave të Marrëveshjes së Grantit. Pavarësisht nga sa më sipër, nëse Përfutuesi është Vendi Anëtar, ky Seksion nuk do të autorizojë asnjë regjistrim të vendimit ose zbatimit të vendimit kundër Vendi Anëtar, përveç nëse një procedurë e tillë mund të jetë e disponueshme ndryshe se sa në bazë të dispozitave të këtij seksioni.

l) Dorëzimi i çdo njoftimi ose procesi në lidhje me ndonjë procedurë nën këtë seksion ose në lidhje me çdo procedurë për të zbatuar ndonjë vendim të dhënë në përputhje me këtë seksion, mund të kryhet në mënyrën e parashikuar në seksionin 10.01. Palët e Marrëveshjes së Grantit heqin dorë nga çdo dhe të gjitha kërkesat e tjera për dorëzimin e çdo njoftimi apo procesi të tillë.

Neni VI **Efektiviteti; Përfundimi**

Seksioni 6.01. *Efektiviteti*

Nëse nuk përcaktohet ndryshe në Marrëveshjen e Grantit, Marrëveshja e Grantit do të hyjë në fuqi në datën në të cilën është ekzekutuar nga të gjitha palët e Marrëveshjes së Grantit.

Seksioni 6.02. *Përfundimi*

Marrëveshja e Grantit dhe të gjitha detyrimet e palëve sipas saj do të përfundojnë menjëherë kur të gjitha detyrimet e tilla të jenë kryer plotësisht.

Neni VII **Dispozita të ndryshme**

Seksioni 7.01. *Ekzekutimi i Marrëveshjeve të Grantit; Njoftimet dhe Kërkesat*

a) Çdo Marrëveshje Granti e ekzekutuar me Mjete Elektronike do të konsiderohet origjinale, dhe në rastin e ndonjë Marrëveshjeje Granti që nuk ekzekutohet me Mjete Elektronike në disa kopje, secila kopje do të jetë një origjinal.

b) Çdo njoftim ose kërkesë që kërkohet ose lejohet të bëhet ose jepet sipas ndonjë Marrëveshjeje Granti ose ndonjë marrëveshjeje tjetër ndërmjet palëve të parashikuara nga Marrëveshja e Grantit, do të jetë me shkrim. Njoftimi ose kërkesa e tillë do të konsiderohet se është dhënë ose bërë siç duhet kur është dërguar dorazi, me postë ose mjete elektronike te pala në të cilën do të jepet ose bëhet në adresën e palës së tillë ose Adresën Elektronike të specifikuar në Marrëveshjen e Grantit ose në një adresë tjetër ose Adresë Elektronike, pasi pala e tillë do të ketë caktuar me njoftim për palën që jep njoftimin ose bën një kërkesë të tillë. Çdo njoftim ose kërkesë e dorëzuar me Mjete Elektronike do të konsiderohet e dërguar nga dërguesi nga Adresa e tij Elektronike kur largohet nga Sistemi i Komunikimeve Elektronike të dërguesit dhe do të konsiderohet e marrë nga pala tjetër në Adresën e saj Elektronike, kur njoftimi ose kërkesa e tillë mund të merret në format të lexueshëm nga makineria nga Sistemi i Komunikimeve Elektronike të palës marrëse.

c) Nëse Palët nuk bien dakord ndryshe, Dokumentet Elektronike do të kenë të njëjtën fuqi dhe efekt juridik si informacioni i përfshirë në një Marrëveshje Granti ose një njoftim ose kërkesë, sipas një Marrëveshjeje Granti që nuk ekzekutohet ose transmetohet me Mjete Elektronike.

Seksioni 7.02. Veprimi në emër të Përfituesit

Përfaqësuesi i caktuar nga Përfituesi në Marrëveshjen e Grantit për qëllimin e këtij seksioni, (ose çdo person i autorizuar nga një përfaqësues i tillë për qëllimin) ("Përfaqësuesi i Përfituesit"), mund të ndërmarrë çdo veprim që kërkohet ose lejohet të ndërmerret, në përputhje me Marrëveshjen e Grantit dhe ekzekutojë çdo dokument ose dërgojë çdo ndonjë Dokument Elektronik, që kërkohet ose lejohet të ekzekutohet në përputhje me Marrëveshjen e Grantit në emër të Përfituesit.

Seksioni 7.03. Provat e Autoritetit

Përfituesi do t'i paraqesë Bankës: a) prova të mjaftueshme të autoritetit të Përfaqësuesit të Përfituesit; dhe b) nënshkrimin model të vërtetuar të përfaqësuesit të tillë si dhe Adresën Elektronike të përmendur në seksionin 7.01(b)

Seksioni 7.04. Nxjerrja e Informacionit

Banka mund të zbulojë Marrëveshjen e Grantit dhe çdo informacion në lidhje me Marrëveshjen e Grantit në përputhje me politikën e saj për akses në informacion, në fuqi në kohën e zbulimit të tillë.

SHTOJCA PËRKUFIZIMET

1. "Rast Shtesë Pezullimi" nënkupton çdo rast pezullimi të specifikuar në Marrëveshjen e Huas për qëllimin e seksionit 7.02 (m).

2. "Udhëzime antikorrupsion" nënkupton "Udhëzimet për Parandalimin dhe Luftimin e Mashtrimit dhe Korrupsionit në Projektet e Financuara nga Huat e BNRZH-it dhe Kreditë dhe Grantet e IDA", siç përcaktohet më tej në Marrëveshjen e Grantit.

3. "Tribunal Arbitrazhi" nënkupton gjykatën e arbitrazhit të krijuar në përputhje me seksionin 5.03.

4. "Banka" nënkupton: a) BNRZH nëse Granti bëhet ose administrohet nga BNRZH; b) IDA nëse Granti bëhet ose administrohet nga IDA; dhe c) bashkërisht, BNRZH dhe IDA, nëse Granti bëhet ose administrohet nga të dy, BNRZH dhe IDA.

5. "Data e Mbylljes" nënkupton datën e specifikuar në Marrëveshjen e Grantit (ose një datë tjetër, siç do të vendosë Banka, me kërkesë të Përfituesit, me njoftim për Përfituesin) pas së cilës

Banka, me njoftim për Përfituesin, mund të përfundojë të drejtën e Përfituesit për t'u tërhequr nga Llogaria e Grantit.

6. “Dollar”, “\$” dhe “USD” nënkupton çdo Valutë të ligjshme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

7. “Adresë Elektronike” nënkupton caktimin e një adrese që identifikon në mënyrë unike një person (ose palë) brenda një sistemi të caktuar të komunikimeve elektronike për qëllime të vërtetimit të dërgimit dhe marrjes së dokumenteve elektronike.

8. “Sistem i Komunikimeve Elektronike” nënkupton marrjen e kompjuterëve, serverëve, sistemeve, pajisjeve, elementeve të rrjetit dhe harduerëve dhe softuerëve të tjerë të përdorur për qëllime të gjenerimit, dërgimit, marrjes ose ruajtjes ose përpunimit të dokumenteve elektronikë, të pranueshëm nga Banka dhe në përputhje me çdo udhëzim të tillë shtesë që mund të specifikojë Banka herë pas here me njoftim për Përfituesin.

9. “Dokument Elektronik” nënkupton informacionin që përfshihet në një Marrëveshje Granti ose njoftim ose kërkesë sipas një Marrëveshjeje Granti që transmetohet me Mjete Elektronike.

10. “Mjete Elektronike” nënkupton gjenerimin, dërgimin, marrjen, ruajtjen ose përpunimin e një dokumenti elektronik me mjete elektronike, magnetike, optike ose mjete të ngjashme, duke përfshirë, por pa u kufizuar të shkëmbimi elektronik i të dhënave, posta elektronike, telegrami, teleksi ose telekopja, të pranueshme nga Banka.

11. “Shpenzim i Pranueshëm” nënkupton një shpenzim, pagesa për të cilën plotëson kërkesat e seksionit 3.06 dhe që rrjedhimisht është i pranueshëm për financim nga të ardhurat e Grantit.

12. “Pasqyra Financiare” nënkupton pasqyrat financiare që do të mirëmbahen për Projektin në përputhje me seksionin 2.07.

13. “Grant” nënkupton grantin e parashikuar në Marrëveshjen e Grantit.

14. “Llogari e Grantit” nënkupton llogarinë e hapur nga Banka në librat e saj në emër të Përfituesit në të cilin kreditohet Granti në përputhje me seksionin 3.01(a).

15. “Marrëveshje Granti” nënkupton marrëveshjen e grantit ndërmjet Përfituesit dhe Bankës, që parashikon Grantin, ku një marrëveshje e tillë mund të ndryshohet herë pas here. “Marrëveshja e Grantit” përfshin këto Kushte Standarde siç zbatohen në Marrëveshjen e Grantit, dhe të gjitha shtojcat, skedulet dhe marrëveshjet shtesë të Marrëveshjes së Grantit.

16. “BNRZH” nënkupton Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim.

17. “IDA” nënkupton Asociacionin Ndërkombëtar të Zhvillimit.

18. “Vendi Anëtar” nënkupton anëtarin e Bankës në territorin e së cilës është zbatuar Projekti ose ndonjë nga nënndarjet politike ose administrative të anëtarit të tillë. Nëse Granti jepet nga Banka për një anëtar të tillë, si palë në Marrëveshjen e Grantit, termi “Vendi Anëtar” dhe “Përfitues” i referohen të njëjtit subjekt.

19. “Plani i Prokurimit” nënkupton planin e prokurimit të Përfituesit për Projektin, i parashikuar në seksionin IV të Rregullores së Prokurimit, ku një plan i tillë mund të përditësohet herë pas here me miratimin e Bankës.

20. “Rregulloret e Prokurimit” nënkupton “Rregulloret e Prokurimit të Bankës Botërore për Përfituesin nën Financimin e Projektit të Investimit”, siç përcaktohet më tej në Marrëveshjen e Grantit.

21. “Projekt” nënkupton projektin e përshkruar në Marrëveshjen e Grantit, për të cilin është bërë Granti, ku përshkrimi i një projekti të tillë mund të ndryshohet herë pas here me marrëveshje midis Përfituesit dhe Bankës.

22. “Raport i Projektit” nënkupton çdo raport mbi Projektin që do të përgatitet dhe dorëzohet në Bankë për qëllimet e seksionit 2.06 (b).

23. “Përfitues” nënkupton palën në Marrëveshjen e Grantit në të cilën bëhet Grant.

24. “Përfaqësuesi i Përfituesit” nënkupton përfaqësuesin e referuar në seksionin 7.02 të caktuar nga Përfituesi në Marrëveshjen e Grantit ose i autorizuar me shkrim nga një përfaqësues i tillë për qëllimet e seksionit të tillë.

25. “Angazhim i veçantë” nënkupton çdo angazhim të veçantë të lidhur ose që do të lidhet nga Banka në përputhje me seksionin 3.03.
26. “Taksat” përfshijnë shuma të pagueshme, detyrime, tarifa dhe tatime të çdo natyre qoftë në fuqi në datën e Marrëveshjes së Grantit ose të vendosura pas asaj date.
27. “Arbitër” nënkupton arbitrin e tretë të caktuar në përputhje me seksionin 5.03(c)(iii).
28. “Udhëzime të Disbursimit të Bankës Botërore për Projektet” nënkupton udhëzimet e Bankës, të rishikuara herë pas here, dhe të lëshuara si pjesë e udhëzimeve shtesë të referuara në Seksionin 3.01.